

**Deklarimi i Tatimit në të Ardhurat  
Personale:  
*Çka Duhet të Dini?*  
Viti tatimor 2010**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO**

QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO

**ADMINISTRATA TATIMORE e KOSOVES**  
**PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA**  
**TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO**

[www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)  
[info@atk-ks.org](mailto:info@atk-ks.org)



## Përmbajtja

<b>Misioni ynë</b> .....	<b>1</b>
<b>Në lidhje me këtë Udhëzues</b> .....	<b>2</b>
<i>Para se të filloni</i> .....	2
<b>Në lidhje me Ligjin mbi Tatimin në të Ardhurat Personale të Kosovës</b> .....	<b>4</b>
<i>Kur duhet të dorëzoni?</i> .....	4
<i>Cilat janë normat e tatimit mbi të ardhurat personale?</i> .....	4
<i>Mbajtja e shënimeve</i> .....	4
<i>Si duhet të regjistroni?</i> .....	5
<b>Çka është e re këtë vit tatimor</b> .....	<b>7</b>
<b>Deklarata mbi të ardhurat personale, kuti për kuti</b> .....	<b>9</b>
<i>Faqe 1: Identifikimi</i> .....	9
<i>Pjesa I: Të ardhurat</i> .....	10
<i>Pjesa II: Zbritjet</i> .....	12
<i>Pjesa III:Zbritjet shtesë</i> .....	19
<i>Pjesa IV: Tatimi i mbajtur në burim gjatë vitit</i> .....	21
<i>Pjesa V: Shuma e papaguar apo rimbursimi</i> .....	22
<b>Të njohurit me faqen 3, Të ardhurat dhe Shpenzimet sipas Aktivitetit</b> .....	<b>23</b>
<i>Të ardhurat nga aktivitetet operative</i> .....	23
Të ardhurat nga ndërtimet afatgjata .....	23
Të ardhurat nga lizingu .....	26
<i>Shpenzimet nga aktivitetet operative</i> .....	26
<b>Pasi të dorëzoni</b> .....	<b>29</b>
<i>Çka ndodh me deklaratën tuaj pasi e pranojmë?</i> .....	29
<i>Kur mund të pritni për rimbursim?</i> .....	29
<i>Cilat janë ndëshkimet dhe interesat që i aplikojmë?</i> .....	29
<i>Çka nëse auditoheni?</i> .....	30
<i>Kur do të më vizitojë inspektori tatimor?</i> .....	31
<b>Ku duhet drejtuar për ndihmë</b> .....	<b>32</b>

## Misioni ynë...

- ***Maksimizimi i përmbushjes vullnetare***, duke i kushtuar rëndësi legjilacionit tatimor dhe rregulloreve,
- ***Ofrimi i shërbimeve profesionale, transparente dhe efikase për komunitetin e tatimpaguesve në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre tatimore, dhe***
- ***Sigurimi i aplikimit të barabartë dhe fuqizimi i legjislacionit tatimor në mënyrë që të mbledhen të hyrat për buxhetin e qeverisë në mënyrë efektive dhe kost-efikase.***

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

## Në Lidhje me këtë Udhëzues

Ky udhëzues është për tatimpaguesit që regjistrojnë *Deklaratën Vjetore të Tatimit në të Ardhurat Personale* (Formulari PD), duke filluar nga viti tatimor 2010. Ky dokument është i bazuar në ligjet e reja të miratuara në 2009, të cilët kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2010.

Tatimpaguesit të cilët duhet të deklarojnë Tatimin në të Ardhurat Personale (TAP) përfshijnë:

- Një individ (i quajtur edhe person fizik) me ndonjë burim të të ardhurave nga aktivitetet jo-biznesore nga të cilat nuk është mbajtur tatimi në burim nga paguesi gjatë vitit tatimor
- Një individ i cili drejton një biznes të "vogël" (me të ardhura vjetore prej 50.000 € ose më pak) i cili deklaron në bazë të paragjykuar dhe i cili pranon të ardhura tjera të tatueshme. Një biznes i "vogël", i drejtuar nga një individ (dmth. vetë-punësuar) me bruto të ardhura vjetore prej 50.000 € ose më pak që vullnetarisht zgjedh të deklarojë fitimin në bazë-reale (Shih më poshtë: Mbajtja e të dhënave)
- Një biznes i "madh" i drejtuar nga një individ me të ardhura vjetore bruto prej më shumë se 50.000 €.
- Një individ jo-rezident me seli të përhershme të biznesit në Kosovë

Ata, nga të cilët nuk kërkohet të deklarojnë TAP përfshijnë:

- Individët të cilët drejtojnë biznese të "vogla" (me të ardhura vjetore prej 50,000€ apo më pak) të cilët paguajnë tatim në bazë të paragjykuar dhe dorëzojnë *Formularët e tatimit tremujor dhe kontributet pensionale për biznese të vogla individuale* të cilët nuk kanë burime tjera të të ardhurave të tatueshme.
- Personi fizik me të ardhura nga të cilat është mbajtur tatimi në burim nga paguesi gjatë vitit tatimor p.sh. atyre ku burimi i vetëm i të ardhurave ka qenë nga paga ku punëdhënësi ka mbajtur tatimin në burim nga ato paga gjatë tërë vitit. Nëse nuk është mbajtur tatimi në burim, atëherë individi duhet të deklarojë TAP.

Që nga 1 janari 2010, këta tatimpagues të cilët deklarojnë në bazë reale të fitimit duhet poashtu të dorëzojnë një deklaratë të re, *Deklarata e të Ardhurave dhe Shpenzimeve sipas Veprimtarisë*. Ky formular shtypet automatikisht si pjesë e deklaratës për TAP për ata tatimpagues nga të cilët kërkohet të dorëzojnë.

### Shkurtesat e Zakonshme

ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
NF	Numri fiscal
PF	Pasqyra financiare
TAK	Tatimi në të ardhurat e korporatave
TAP	Tatimi në të Ardhurat Personale
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi
UA	Udhëzimi administrativ

### Para se të filloni...

- Lexoni këtë udhëzues me kujdes. Kjo do të ju ndihmojë që ti shmangeni gabimeve.
- Nëse keni nevojë për më shumë informata, rishikoni ligjet dhe udhëzimet përkatëse administrative, të disponueshme në faqen e internetit të ATK-së ([www.atk.ks.org](http://www.atk.ks.org)) nën lidhësen *Legjislacioni*. Ato përfshijnë:
  - Ligji nr 03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale

- Udhëzimet Administrative Nr 9 / 2010 dhe 13/2010
- Ligji Nr 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat
- Udhëzimi Administrativ nr 15/2010

Ju mund të gjeni edhe informata të dobishme në seksionin *Pyetjet më Shpesh të Pyetura* në faqen e internetit të ATK.-së

- Nëse ju nuk mund ta gjeni përgjigjet në pyetjeve tuaja, ju mund të kontaktoni ATK-në. Kapitulli i fundit i këtij udhëzuesi shpjegon se si të bëhet kjo (f. 29).

## Në Lidhje me Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat Personale të Kosovës

### Kur duhet të dorëzoni?

Viti tatimor i Kosovës (periudha tatimore) zgjat nga 1 janari deri 31 dhjetor.

- **Deklarata Vjetore duhet të dorëzohet deri më 31 mars të vitit vijues. Çdo tatim i papaguar duhet të paguhet deri në këtë datë.**

Nëse 31 marsi është e shtune, e diele apo ndonjë festë zyrtare, atëherë data përkatëse është dita e ardhshme e punës..

### Cilat janë normat e tatimit mbi të ardhurat personale?

Nëse e ardhura e juaj vjetore e tatuar është:	Atëherë ju paguani:
960€ apo më pak	0%
960€ deri 3,000€	4% e shumës mbi 960€
3,000€ deri 5,400€	81.60€ plus 8% e shumës mbi 3,000€
Më shumë se 5,400€	273.60€ plus 10% e shumës mbi 5,400€

### Mbajtja e shënimeve

- Të gjithë tatimpaguesit duhet të mbajnë nga një kopje të deklaratës tatimore, së bashku me dokumentet të cilat përkrahin shumat e deklaruara në te. Këto të dhëna duhet ti vihen në dispozicion ATK-së, sipas kërkesës. Shembuj të dokumenteve përkatëse përfshijnë: dëshmi për të ardhurat, dëshmi për shpenzimet, faturat për shpenzimet nga afarizmi, dhe dëshmitë mbi pagesat e lidhura me qira, fitoret nga lojërat e fatit, fitim kapital.
- Bizneset e “mëdha” të drejtuara nga individët me të ardhura vjetore bruto mbi 50,000€, dhe bizneset e “vogla” të drejtuara nga individët me të ardhura vjetore bruto prej 50,000€ apo më pak të cilët zgjedhin të raportojnë në bazë reale.
- Duhet të përdorin sistemin e kontabilitetit në bazë përlllogaritëse në përputhje me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës. Kjo nënkupton se e ardhura është raportuar gjatë periudhës tatimore kur 1) mallrat janë furnizuar, 2) shërbimet janë kryer, 3) faturat janë lëshuar ose 4) paratë janë marrë, cilado që ndodh e para. Metoda e kontabilitetit duhet të jetë në përputhje me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës. Këto biznese duhet poashtu të regjistrohen për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).
- Biznesi i “vogël” i drejtuar nga individët me të ardhura vjetore prej 50,000€ apo më pak të cilët regjistrojnë në bazë të paragjykuar janë të obliguar të regjistrojnë transaksionet e tyre në bazë të parasë së gatshme.
- Bizneset me qarkullim nën 5,000€ **nuk janë të liruar** nga mbajtja e llogarive.

### Si duhet të regjistroni?

- Shko në faqen e internetit të ATK-së dhe kliko mbi pjesën *Shkarko formularët tatimor* në anën e majtë të navigimit
- Shkruani numrin tuaj fiskal. Emri i juaj duhet të shfaqet automatikisht. (Nëse jo, sigurohuni që keni shkruar NF të saktë)
- Zgjedh formularin PD, *Tatimi në të ardhurat personale*, dhe shkruaj periudhën tatimore.
- Mëpastaj, zgjedh njëri nga tri opsionet e mëposhtme:

- Tatimi në bazë reale të fitimit: për bizneset e mëdha individuale dhe bizneset e vogla individuale të cilat zgjedhin të paguajnë në baza reale të fitimit .
- Tatimi i paragjykuar: për individët më biznese të “vogla” (me të ardhura vjetore prej 50,000€ apo më pak) të cilët kanë së paku edhe një burim tjetër të të ardhurave të tatueshme
- Personi fizik: për individët me çfarëdo të ardhure jo-biznesore nga të cilat nuk është mbajtur tatimi në burim gjatë vitit tatimor
- Kopjo kodin e sigurisë siç e treguar dhe kliko *“Shkarko Deklaratën!”* Kjo do të hap deklaraten e TAP në format të PDF.
  - Nëse regjistroni si person fizik apo në bazë të paragjykuar, deklarata do të përbëhet nga dy faqe.
  - Nëse paguani tatim në baza reale të fitimit, atëherë PDF-ja do të përfshijë deklaraten e re dhe e cila do të përbëhet nga tri faqe..
- Shtypeni formularin.
- Nëse nuk keni qasje në internet, ju mund të vizitoni zyrën më të afërt regjionale të ATK-së. Banka e juaj lokale mund poashtu të ju ndihmojë në shkarkimin e formularit. (Do të ju duhet numri i juaj fiskal.)
- Konfirmo që adresa dhe detajet tjera të shtypura janë të sakta. Nëse jo, kjo duhet të ndryshohet tek zyra regjionale e ATK-së.
- Bëni llogaritjet dhe plotësoni deklaraten në plotni. Përdorni ngjyrë të errët.
- Shkruani shumën negative në kllapa. Për shembull, humbja prej 200€ duhet të shkruhet (200).
- Kur të plotësoni formularin, duhet ta nënshkruani dhe datoni deklaraten në fushat e ofruara.
- Bëni kopje të të gjitha dokumenteve dhe mbajini ato në regjistrat tuaj.
- Nëse keni tatim të papaguar, sjelli formularët tuaj dhe bëni pagesën në ndonjërin prej bankave në Kosovë
- Nëse keni paguar shumën e tepërt apo të saktë, dhe nuk keni nevojë të bëni ndonjë pagesë, ju mund të dorëzoni formularët tuaj në ndonjërin nga zyrat regjionale të ATK-së apo të bankës. (Vini re se banka mund të ngarkoj për përpunim).

### Si t'i shmangni gabimet dhe vonesat

- ✓ Përdorë formularin me numrin tuaj fiskal të shtypur. Mos Fotokopjoni formularin e dikujt tjetër dhe të ndërroni NF.
- ✓ Sigurohuni që ju keni shkarkuar deklaraten e duhur.
- ✓ Bëni të gjitha llogaritjet në euro, asnjë monedhë tjetër nuk është e lejuar.
- ✓ Sigurohuni që humbja të theksohet në kllapa. Për shembull: (200€).
- ✓ Kontrolloni adresën, emrin dhe informatat kontaktuese.
- ✓ Nënshkruani deklaraten; nuk është e vlefshme e pa nënshkruar.
- ✓ Plotësoni të gjitha informacionet e nevojshme; kutitë e zbrazëta mund të vonojnë përpunimin e deklaratës tuaj.

## Çka është risi në këtë vit tatimor?

Me 1 janar 2010, Ligji i ri mbi Tatimin në të Ardhurat Personale dhe procedurat administrative kanë hyrë në fuqi. Këto ligje mbulojnë vitin tatimor 2010 dhe ligjet pasuese. Ndryshimet që kanë ndikuar paguesit e TAP përfshijnë:

- **Rishikimi i ligjit për TAP** si ajo e lidhur me:
  - **Mbajtjen në burim:** përfshin mbajtjen në burim të tatimit në pagesat e interesave dhe drejtave pronësore, fitimeve nga lotaritë dhe lojërave të fatit e cila poashtu përfshin ngarkesat ndaj zbatuesve jo-rezident dhe disa jo-rezidentë të caktuar të cilët ofrojnë shërbime në Kosovë (*Shiko UA Nr. 8/2010 për më shumë detaje.*)

*Për bizneset e “mëdha” dhe të “vogla” të drejtuara nga individët në baza reale të fitimit, ndryshimet e mëposhtme janë poashtu të rëndësishme:*

- **Vlerësimi i inventarit:** ndalon përdorimin e LIFO (i fundit brenda - i pari jashtë) metodës për qëllime tatimore, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
  - **Ndërtimi afat-gjatë:** përcakton ndërtimin afatgjatë, dallon mes *ndërtuesve, investitorëve dhe ndërtuesve / investitorëve*, dhe sqaron kërkesat për llogaritjen e të ardhurave.
  - **Shpenzimet e reprezentacionit:** lejon zbritje 100% të publicitetit dhe reklamimit duke lejuar zbritje 50% për shpenzimet e argëtimit deri në 2% të bruto të ardhurave vjetore.
  - **Borxhet e këqija:** lehtëson kërkesat në lidhje me “shlyerjen” dhe mbledhjen e borxhit të keq
  - **Zhvlerësimi:** kërkon një metodë lineare për llogaritjen e zhvlerësimit për qëllime tatimore, sqaron se sa amortizim mund të kërkohe mbi pasuritë gjatë vitit të parë të përdorimit të tyre, ndryshimet në trajtimin e mjeteve të grumbulluara dhe shtimi i një dispozitë të re në amortizimin e kafshëve.
  - **Riparimet dhe përmirësimet:** kërkon riparimet dhe përmirësimet mbi 1.000 € që do të kapitalizohen nëse ato zgjatin jetën e pasurisë, përndryshe lejon zbritjen e menjëhershme të kostos
  - **Transferimi i çmimi:** përcakton dispozita të reja të bazuara në praktikat ndërkombëtare.
- **Një rishikim i administratës tatimore dhe procedurave** lidhur me numrat fiskal, regjistrimin e biznesit, arkat fiskale, kërkesat për regjistrime, auditime, mbledhje e detyruar dhe ndëshkimet. Ndërsa disa dispozita të këtij ligj janë diskutuar në këtë udhëzues, UA nr 15/2010 ofron një pasqyrë të detajuar (në dispozicion në faqen e internetit të ATK-së.)
  - **Një deklaratë e re financiare që shoqëron deklaratën e TAP** e quajtur *deklarata e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas veprimtarisë*, e cila kërkon përmbledhjen e informacionit nga të dhënat financiare të biznesit. Ky formular shtypet automatikisht me deklaratën e TAP-it për ata që kërkohe të regjistrojnë. Ajo duhet të plotësohet dhe dorëzohet me deklaratën e TAP-it.
  - **Një formular i ri për Deklaratën Vjetore të të Ardhurave nga Ortakëria.** Ky formular duhet të dorëzohet në ATK deri më 31 mars nga personi përgjegjës i ortakërisë biznese, duke përfshirë ortakërinë e kufizuar dhe të përgjithshme. Formulari është në dispozicion në faqen e internetit të ATK-së.

## Deklarata e Tatimit për të Ardhurat Personale, Kuti për kuti

### ***Për regjistruesit jo-biznesor:***

Për të plotësuar deklaratën e TAP, do të ju duhet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Çertifikata e pagave bruto vjetore
- Deklaratat e pagesave bëra nga ju apo në emër tuajin në TSPK apo të ndonjë fondi tjetër pensional
- Deklaratat e lidhura me të ardhura tjera, duke përfshirë interesat nga kreditë apo llogaritë bankare, fitimet nga lotaria, fitimi kapital, e ardhura me burim të huaj, e ardhura nga pasuria e patrupëzuar dhe çfarëdo e ardhur tjetër, nëse ka
- Çertifikatat e mbajtjes në burim të pagave, interesave, qirasë apo fitimeve nga lotaria
- Faturat për kontributet bamirëse, nëse ka

Ju duhet të ofroni informata në kutitë [8] dhe cilado qoftë kuti prej [9] – [18] e cila i përket gjendjes tuaj.

### ***Për regjistruesit biznesor:***

Për të plotësuar TAP, do të ju duhet të llogaritni të ardhurat tuaja neto.

Nëse jeni biznes individual, që bënë regjistrimin në baza të paragjykuar, ofroni informatat në kutinë [9] bazuar në shitjet e juaja bruto vjetore. Dhe cilado qoftë kuti [10] – [18] që i përket gjendjes suaj.

Nëse jeni biznes individual që regjistroni në bazë reale të fitimit, filloni duke plotësuar faqen 3, deklaratën financiare, *Deklaratën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas aktivitetit*. Plotësoje duke përdorur të dhënat nga pasqyrat financiare të biznesit dhe referojuni këtij udhëzuesi për sqarim të detajuar të secilës kuti.. (Shiko faqen 3, *Të ardhurat dhe shpenzimet sipas aktivitetit, faqe 20*)

Pasi të keni neto fitimin tuaj, shkruani shumën në faqen 2, kutia [9].

Kjo pjesë e udhëzuesit sqaron secilën kuti të deklaratës, në mënyrë që duke përdorur shembujt të diskutohet dhe sqarohet aplikimi praktik i ligjit.

### ***Faqe 1: Identifikimi***

Kjo pjesë mbulon informatat bazike në lidhje me tatimpaguesin dhe natyrën e regjistrimit.

#### **Kutia [1]**

*Periudha tatimore:* viti kalendarik për të cilin ju jeni duke deklaruar të ardhurat (për shembull, “2010.”)

#### **Kutia [2]**

*UNIREF:* ky barkod i shtypur ka lidhje me sistemin elektronik të ATK-së për mbajtjen e shënimeve. Mos shkruaj mbi këtë barkod.

**Kutia [3]**

*Numrat fiskal:* numri i tatimpaguesit. Ky numër do të paraqitet në formularin tuaj. Sigurohuni të shkarkoni formularin me numrin tuaj fiskal. Nuk pranohet fotokopja e formularit dhe ndërrimi i numrit fiskal me ngjyrë.

**Kutia [3a]**

*Numri individual ID:* numri individual i tatimpaguesit . Ky numër do të paraqitet në formularin tuaj.

**Kutia [4]**

*Emri i tatimpaguesit:* emri i tatimpaguesit.

**Kutia [5]**

*Adresa e tatimpaguesit:* adresa postare e tatimpaguesit.

**Kutia [6]**

*Telefoni:* numri i telefonit i tatimpaguesit.

**Kutia [7]**

Nëse kjo është deklaratë e re, lëreni të zbrazët këtë pjesë. Nëse ky formular paraqet ndryshimin e deklaratës paraprake, shkruani X në kutinë përkatëse:

- Shtesë – për të deklaruar të ardhura apo zbritje .
- Përmirësim – për të përmirësuar gabimin nga deklarata paraprake.
- Vetëm pagesa – për pagesë të detyrimit tatimor të papaguar paraprakisht

**Zona e hijezuar****Kutia [47]**

*Shuma e papaguar:* nga kutia [42] në faqen 2 e kësaj deklarate.

**Kutia [48]**

*Shuma e tatimit të paguar:* shuma e tatimit të cilin ju e paguani me këtë deklaratë

**Kutitë zbritëse**

*Kutia e nënshkrimit dhe data:* Nënshkruaj dhe datoj deklaratën. Nuk do të jetë e vlefshme pa qenë e nënshkruar dhe me date.

*Pjesa e bankës:* Banka shfrytëzon këtë pjesë për të regjistruar pagesën tuaj. Mos shkruani në këtë zonë.

*Faqe 2, Llogaritja e tatimit*

***Pjesa I: Të Ardhurat***

Përdore këtë pjesë për të raportuar të ardhurat nga të gjitha burimet. Nëse nuk keni asgjë për të raportuar në këtë zonë, shkruaj “0” në kuti.

Duke filluar nga 1 janari 2010, **dividendët janë të liruara nga tatimi** dhe nuk është nevoja të deklarohen sit ë hyra.

#### **Kutia [8]**

*Pagat bruto:* Trego shumën totale e cila iu është paguar nga punëdhënësi i juaj në formë të pagave gjatë vitit tatimor.

#### **Kutia [9]**

*Neto e ardhura nga biznesi nga kutia [78] e PF:* të gjithë regjistruerit individual duhet të raportojnë të ardhurat e tyre neto në këtë kuti [9].

- Nëse llogaritni në bazë paragjykuar (p.sh. para të gatshme), ofroni këtë shumë nga shënimet e juaja.
- Nëse llogaritni në bazë reale të fitimit, llogaritni këtë shumë duke përdorur faqen 3, pasqyrën financiare, me informatat nga deklarata e të ardhurave të biznesit (*poashtu e njohur si Bilanci i suksesit*). Totali në kutinë [78] i pasqyrës financiare duhet të raportohet këtu. Për më shumë detaje në lidhje me kalkulimin, shiko *Të njohurit me faqen 3, të ardhurat dhe shpenzimet sipas aktivitetit*, faqe 20.

Nëse biznesi ka humbje neto, atëherë shkruaj shumën në kllapa. Për shembull, humbja prej 10,000€ do të duhet paraqitur si (10,000€).

#### **Kutia [10]**

*Të ardhurat neto nga ortakëria janë në listën shpërndarëse:* Nëse jeni pjesë e ortakërisë, ju duhet të deklaroni pjesën e të ardhurave të cilat i realizoni nga ortakëria. Vini re se duke filluar nga 1 janari 2010, të gjitha ortakëritë janë të obliguara të deklarojnë (disponueshme në uebfaqen e ATK-së) listën me totalin e të ardhurave nga ortakëria, emrat e anëtarëve të saj, dhe përqindjen e fitimit të secilit ortak. Referojuni kësaj deklarate për të përcaktuar pjesën tuaj të të ardhurave neto nga ortakëria dhe shkruani atë shumë këtu.

#### **Kutia [11]**

*Qiraja bruto:* Dekloni këtu fitimet gjatë vitit tatimor nga qiraja në prona apo asetet e gjendura në Kosovë. (Nëse jeni banor i Kosovës dhe realizoni të ardhura nga pronat që janë jashtë Kosovës, përfshini këtë në kutinë [17])

#### **Kutia [12]**

*Të ardhurat bruto nga pagesa e pensioneve:* Dekloni këtu pagesat e pensioneve të bëra juve gjatë vitit tatimor nga skemat e pensioneve të TKPK dhe fondit privat.

#### **Kutia [13]**

*Të ardhurat bruto nga interesi:* Dekloni këtu çfarëdo interesi i paguar juve në lidhje me kreditë, letrat me vlerë, fletëobligacioneve dhe llogarive bankare. Interesi në pagesat nga bonot e thesarit (Qeverisë) dhe TKPK janë të liruara nga tatimi

#### **Kutia [14]**

*Të ardhurat bruto nga fitimet në lotari:* deklaroni këtu çfarëdo fitimi nga fitimet në lotari .

#### **Kutia [15]**

*Të ardhurat bruto nga prona e patrupëzuar:* Dekloni këtu pagesat e realizuara në lidhje me shfrytëzimin e pronës së patrupëzuar, siç janë patentat, të drejtat autoriale, licencat për dizajnët dhe modele, kontrata, franshiza dhe asete tjera që rrjedhin nga këto të drejta.

**Kutia [16]**

*Fitimi kapital:* Fitimi kapital paraqet të ardhurën e fituar me anë të shitjes apo shlyerjes së asetit kapital. Deklaroni këtu fitimet nga këto transaksione si shitje të patundshmërisë, të aksioneve dhe fletëobligacioneve, dhe transaksioneve të lidhura me konvertimet e pavullnetshme. Nëse shitja gjeneron humbje, atëherë kjo trajtohet si humbje e zakonshme dhe duhet të shkruhet këtu në kllapa.

**Kutia [17]**

*Burimi i huaj i të ardhurave*

Si banor i Kosovës, ju duhet të raportoni të ardhurat nga të gjitha burimet, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Llojet e të ardhurave përfshijnë të ardhurat nga biznesi, interesi dhe të ardhurat nga burimet tjera, siç janë të ardhurat nga qiraja. Vini re se dividendët janë të liruara nga tatimi.

Nëse vendi përdor valutë tjetër, ju **duhet të bëni konvertimin** në euro duke përdorur kursin e shkëmbimit i aplikueshëm në ditën kur është bërë pagesa. Nëse shuma është paguar gjatë periudhave të ndryshme përgjatë vitit, ju mund të përdorni një mesatare të normës vjetore. Siguroni kursin e shkëmbimit të aplikueshëm nga internet apo banka qendrore e shtetit përkatës të huaj. Pregadituni të demonstroi ATK-së për mënyrën e sigurimit të kursit, është e disponueshme, mënyra e kalkulimit të normës vjetore.

**Kutia [18]**

*Të ardhurat tjera (specifikoji):* Deklaro këtu çfarëdo të ardhure tjetër të tatueshme që nuk është cekur ma lart siç janë çmimet jo në para të gatshme nga lotaria, borxhet e falura apo të ardhurat tjera të cilat kanë rritur vlerën tuaj neto. Specifiko llojin e të ardhurave në vijën me pika.

**Kutia [19]**

*Totali i të ardhurave:* Mblidh kutitë [8] deri [18] për të përcaktuar të ardhurat totale.

**Pjesa II: Zbritjet**

Përdor këtë pjesë për të regjistruar zbritjet nga totali i të ardhurave tuaja. Nëse nuk keni asgjë për të raportuar në këtë pjesë, shkruaj "0" në kuti.

**Kutia [20]**

*Zbritjet për shpenzimet nga qiraja, të tanishme apo 10% të qirasë bruto:* Shkruaj shpenzimet e qirasë të ndodhura gjatë periudhës tatimore. Nëse llogaritni në bazë reale të fitimit, ju lejohet të shkruani shumën aktuale. Nëse jo, atëherë mund të zbritni 10% nga të ardhurat bruto vjetore.

**Kutia [21]**

*Zbritjet për kontributet pensionale (bashkëngjit dokumentet):* Shkruaj shumën totale të kontributeve pensionale që keni realizuar në emër tuajin. Mos përfshini kontributet e punonjësve. Bashkëngjiti deklaratës TAP çertifikatën e cila tregon shumën e kontributeve të bëra.

**Kutia [22]**

*Zbritjet për shpenzimet të lidhura me të ardhurat mbi shfrytëzimin e pronës së patrupëzuar:* Shkruaj shumën e shpenzimeve të ndodhura gjatë periudhës tatimore të lidhur me të ardhurat nga prona e patrupëzuar.

## Kutia [23]

*Zbritjet e tjera të lejuara (specifiko):* Shkruaj shumën e çfarëdo shpenzimi, siç është borxhi i keq, shpenzimet e reprezentacionit, kërkimi dhe zhvillimi, dhe zhvlerësimi. Listo ato në vijën e pikëzuar.

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejuara si zbritje:

- Çmimi i përvetësimit apo përmirësimit të tokës
- Ndëshkimet, gjobat, apo interesi i lidhur
- Tatimi në të ardhura
- Shkruaj TVSh nëse ka rabat, apo kreditë nga output i TVSH-së
- Shpenzimet personale, familjare apo të jetesës
- Shpenzimet për argëtim dhe rekreacion
- Humbja nga shitja apo këmbimi i aseteve në mes të personave të lidhur
- Çfarëdo shpenzimi i padokumentuar

**Udhëzimi administrative Nr. 13/2010 sqaron shtatë pika të lidhura me zbritjet. Dy pikat e mëposhtme vlejné për tatimpaguesit:**

**1 –Shpenzimet e reprezentacionit:** Duke filluar nga viti 2010, shpenzimet e reprezentacionit trajtohen ndryshe:

- Shpenzimet për reklamim, publicitet dhe promovim janë 100% të zbritshme;
- Shpenzimet për zbavitjet gjatë afarizmit janë 50% të zbritshme deri të një kufi prej 2% të ardhurave bruto vjetore.

Shpenzimet për zbavitje duhet të ndodhin në lidhje me biznesin. Shembujt përfshijnë:

- Zbavitjet për klientët potencial, blerësit apo furnitorët;
- Drekat, darkat apo evenimentet që për qëllim kryesor kanë biznesin dhe
- Ngjarjet apo aktivitetet për të mbajtur dashamirësinë e mire me punonjësit.

Mbaj llogari të detajzuar për të gjitha shpenzimet për zbavitje, duke përfshirë datat, emrat e njerëzve dhe bizneset e argëtuara duke përfshirë arsyen e argëtimit. Zbavitjet private apo drekat me shokë, ku biznesi është i rastësishëm, nuk janë shpenzime të lejuara.

**2- Pagesat ndaj personave të lidhur:** Shpërblimet, rrogat, interesat, qiraja dhe shpenzimet tjera të paguara për personat e lidhur janë të lejuara si zbritje por me disa kufizime. Zbritja e lejuar është apo shuma e tanishme e paguar apo vlera e tregut, cilado që është me e ulët. Vlera e tregut mund të përcaktohet në katër mënyra:

- Një vlerësim i çmimit të njëjtit aset në mes një blerësi të vullnetshëm dhe shitësi të vullnetshëm në bazë të një transaksioni të lire;
- Nëse ai krahasim nuk është i mundur, një çmim i përafërt i asetit të njëjtë në rrethana të njëjta;
- Nëse asnjëra nuk është e aplikueshme, atëherë përdor metodën e aplikuar nga ATK e cila ofron një vlerësim të mjaftueshëm; apo
- Nëse asnjëra nga lart nuk funksionon, në bazë të një kostoje shtesë, duke mbledhur totalin e fuqisë punëtore dhe çmimit të materialit plus një vlerë të ngritur përqindjeje. Tatimpaguesi i cili dëshiron të përdorë këtë metodë duhet të ofrojë dokumentet përkatëse për arsyen se pse nuk janë përdorur opsionet tjera.

#### *Shembull*

Biri i pronarit të biznesit është i punësuar në kompani si shofer dhe paguhet 2,000€ në muaj. Vlera e tregut për shërbime të vozitjes është 400€. Për shkak se vozitësi dhe biznesi janë persona të lidhur, shuma prej 400% lejohet si zbritje.

**Pesë pikat e mëposhtme janë të rëndësishme vetëm për bizneset që regjistrojnë kontabilitetin e tyre në baza reale:**

**1 – borxhet e këqija:** Ligji i lejon bizneset të 'shlyejnë' borxhet e këqija, por nga ata kërkon që të përshtatin të ardhurat e tyre në rastet kur/nëse ato borxhe kthehen. Në mënyrë që të bëhet kjo, bizneset duhet të mbajnë shënime të detajizuara për borxhet të këqija, të shlyera dhe kthyer, duke identifikuar borxhliun me emër dhe numër fiskal.

Në kushtet e kontabilitetit, *shlyerje* nënkupton përshtatjet e bëra në librat e tatimpaguesit duke reflektuar zbritjen e vlerës së llogarive të arkëtuara. Normalisht, shuma e zbritur mbahet në llogari të quajtur *dispozita e borxheve të këqija*. Sidoqoftë, për qëllime tatimore, borxhi i keq nuk mund të kërkohe bazuar në llogarinë kalimtare. Në vend të kësaj, duhet të bëhet përshtatja në librat e tatimpaguesit për të reflektuar borxhin e keq si një shpenzim.

Për tu kualifikuar si shpenzim, borxhi duhet të plotësoj dy kritere:

- Borxhi duhet të jetë gjashtë muaj i vjetër, dhe
- Duhet të posedohen *dëshmi adekuate e përpjekjeve të pasuksesshme* për mbledhjen e borxhit.

Dëshmia adekuate përcaktohet si:

- Vendimi i gjyqit që tregon se borxhi nuk mund të mblidhet;
- Dëshmi e shkruar se vepra ligjore nuk do të jetë ost-efektive, apo jo e zbatueshme;
- Konfirmimi zyrtar i përpjekjeve të dështuara për të mbledh borxhin;
- Çertifikata nga organet e rendit se borxhi nuk mund të gjurmohet;
- Dëshmi për vdekjen e borxhliut; apo
- Çfarëdo dokumenti tjetër i cili dëshmon pamundësinë e mbledhjes së borxhit.

Nuk pritet nga tatimpaguesi të heq dorë nga kërkesa e tij/saj për borxh apo të ndërmarr ndonjë tentim në të ardhmen për të mbledh borxhin pasi ai të shlyhet për qëllime tatimore.. Sidoqoftë, çfarëdo borxhi i keq i cili është i zbritur si shpenzim, dhe i mbledhur më vonë, duhet të llogaritet si e ardhur e periudhës tatimore gjatë të cilës është mbledhur..

**2 – Zhvlerësimi:** Ligji lejon zbritjet për zhvlerësim për pronës e trupëzuar në pronësi të tatimpaguesit dhe shfrytëzuar gjatë aktiviteteve ekonomike të tatimpaguesit. Shpenzimi për tokë, punimet e artit, dhe pronat tjera që nuk janë subjekt i konsumit janë të liruara. Për qëllime tatimore, ekzistojnë tri kategori të zhvlerësimit:

- *Kategoria 1* është për ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore.
- *Kategoria 2* është për automobila, kamionë të lehtë, automjete të rënda transportuese, buldozerë, ekskavator, kompjuterë, pajisje periferike dhe pajisje tjera të zyrës për procesim të të dhënave, instrumenteve, gjërave të ndryshme dhe pajisjeve tjera shtesë, bagëtia e përdorur për prodhim apo mbarëstim.

- *Kategoria 3 uzinat dhe makineria*; stoku qarkullues dhe lokomotivat e përdorura për transport hekurudhor; aeroplanët; anijet; bimët shumëvjeçare dhe pemët për vreshtari apo prodhim të frutave (siç janë mollët, dardhët, arrat, boronicat, etj) dhe të gjitha asetet tjera të trupëzuara që nuk janë përfshirë në kategorinë 1 apo kategorinë 2.

*Në bazë lineare*: Zhvlerësimi duhet të kalkulohet në bazë lineare që d.m.th. dallimi në mes të çmimit të asetit dhe vlerës së riaftësimit të pritur me numrin e viteve që pritet të futet në përdorim. Kjo nënkupton:

- Asetet e reja nga kategoria 1, me normë prej 5%, mund të zhvlerësohet në shuma të barabarta përgjatë 20 periudhave tatimore
- Asetet e reja nga kategoria 2, me normë prej 20%, mund të zhvlerësohen në shuma shuma të barabarta përgjatë pesë periudhave tatimore
- Asetet e reja nga kategoria 3, me normë prej 10%, mund të zhvlerësohen në shuma të barabarta përgjatë 10 periudhave tatimore.

### **Shembull**

Në fillim të periudhës tatimore 2010, biznesi X ka blerë ndërtesë prej 1,000,000€, një aset i kategorisë 1 më një zhvlerësim të lejueshëm prej 5%. Metoda lineare funksionon si mëposhtë:

<b>Periudha tatimore</b>	<b>Bilanci fillestar/shtesat</b>	<b>Zhvlerësimi (5%)</b>	<b>Bilanci përmbyllës</b>
2010	1,000,000	-50,000	950,000
2011	950,000	-50,000	900,000
2012	900,000	-50,000	850,000
2029	50,000	-50,000	0

*Metoda e zhvlerësimit*: Zbritja për zhvlerësim është i lejuar kur asetet futen në mirëmbajtje. Këto asete duhet të përdoren vetëm për qëllime të aktivitetit ekonomik.

- Zhvlerësimi vjetor është i lejuar për asetet e vendosura në mirëmbajtje në cilëndo kohë gjatë gjashtë muajve të pare të vitit..
- Zhvlerësimi gjysmëvjeçar është i lejuar për asetet e vendosura në mirëmbajtje në cilëndo kohë gjatë gjashtë muajve të fundit të vitit.

Në të dyja rastet, një zhvlerësim vit-plotë mund të kërkohet në vitet pasuese deri në, duke mos përfshirë, vitin në të cilin asetit është shitur apo shlyer. Në vitin e shitjes apo shlyerjes, fitimi apo humbja kapitale mund të pranohet bazuar në krahasimin në mes të çmimit aktual të shitjes/shlyerjes dhe vlerës kontabël të asetit në fillim të vitit të shitjes/shlyerjes.

### **Shembull**

Biznesi X ka blerë dy automjete në vitin 2010, secili me çmim prej 5,000€. Automjeti i parë është blerë me 15 prill 2010, kurse i dyti me 20 shtator 2010. Në vitin tatimor 2010, zhvlerësimi është i lejuar për automjetin e pare për tërë vitin. Si pjesë e kategorisë 2 të aseteve, shuma e lejuar është 20%, apo 1,000€. Për automjetin e dytë, një zhvlerësim gjysmë-viti është i lejuar në shumë prej 500€. Nga viti 2011 e tutje, një zhvlerësim i një viti të plotë mund të kërkohet për dy automjetet, përpos se automjeti i dytë mund të ketë zhvlerësim gjysmë viti në periudhën përfundimtare të zhvlerësimit, gjysma e pare e vitit 2015.

*Asetet e blera para 1 janarit 2011:* asetet nga kategoria 2 dhe 3 të blera me apo pas 1 janarit 2010 duhet të bëjnë zhvlerësimin në baza individuale duke përdor metodën lineare. Asetet nga kategoria 2 dhe 3 të blera para 1 janarit 2010 të cilat janë zhvlerësuar në grup, duhet të zhvlerësohen në atë mënyrë deri sa vlera e grupit të arrij zero

**Shembull**

Në fillim të vitit tatimor 2010, biznesi X ka në pronësi asetet nga kategoria 2:

- 10 kompjuter nga 1,000€ secili
- 2 fotokopje nga 4,000€ secili
- 2 automobila nga 10,000€ secili

**VLERA TOTALE**

**38,000€**

Në gjysmën e parë të viti tatimor 2010, biznesi ka blerë një fotokopjues tjetër për 5,000€. Asetet origjinale nga kategoria 2 të cilët bilancin fillestar të grupit 38,000€, duhet të zhvlerësohen me metodën lineare më normë prej 20% në vit deri sa vlera e grupit arrij zero. Fotokopjuesi i blerë në 2010 do të zhvlerësohet individualisht duke përdorur metodën lineare me normë 20%, apo 1,000€ në vit.

*Grupimi për asete me vlerë të ulët:* Asetet më çmim blerës deri në 3,000€ duhet të trajtohen ndryshe:

- Asetet e blera për 1,000€ apo më pak mund të shpenzohen në plotni në periudhën tatimore në të cilën janë blerë dhe vënë në funksion.
- Asetet më çmim blerës në mes 1,000€ dhe 3,000€ duhet të regjistrohen në grup të ri (sesa si asete individuale) dhe zhvlerësohen me metodën lineare me normë prej 20%. Me blerjen e asetet shtesë të njëjtës vlerë, çmimi blerës i tyre duhet ti shtohet vlerës së grupit. Kur aseti shitet nga grupi, çmimi blerës duhet të raportohet si e ardhur e zakonshme nga biznesi në periudhën tatimore kur ka ndodhur shitja. Sidoqoftë, shitja nuk do ta zvogëlojë vlerën e grupit.

**Shembull**

Në fillim të vitit 2010, biznesi X ka blerë kompjuter në vlerë prej 2,000€. Në fillim të vitit 2011, biznesi ka blerë makineri për 2,400€. Ka shitur kompjuterin në vitin 2011 për 1,000€. Secili nga këto asete plotëson kriteret të përfshihet në grup. Llogaria e grupit funksionin si mëposhtë:

Periudha tatimore	Bilanci fillestar/shtesat	Zhvlerësimi (20%)	Bilanci përmbyllës
2010	2000	-400	1,600
2011	1,600, + 2,400	-800	3,200
2012	3,200	-640	2,560

Për vitin tatimor 2012, shuma prej 2,000€ (çmimi blerës i kompjuterit) do të përfshihet si e hyrë e tatueshme por nuk do të bëhen përshtatje në llogarinë e grupit. Grupi do të vazhdojë më zhvlerësim 20% në secilën periudhë tatimore i aplikuar në bilancin fillestar duke përfshirë ndonjë shtesë.

*Zhvlerësimi i bazuar në çmimin e kostos historike:* Normalisht, zhvlerësimi i aseteve bazohet në çmimin e kostos historike. Sidoqoftë, bazuar në rrethanat e pas luftës në Kosovë, Drejtori i

Përgjithshëm i ATK-së mund të konsideroj qasje alternative për ndërmarrjet në pronësi shoqërore apo publike bazuar në rrethanat dhe të lëshoj vendim duke lejuar rivlerësim të bazës.

*Riparimet e kapitalizuara dhe përmirësimet:* ligji bën dallim në mes të riparimeve ditore dhe atyre që në mënyrë të konsiderueshme rrisin kapacitetin. Jetën, kushtet, dhe produktivitetin e asetit . Për shembull:

- Për një ndërtesë, ri-mbulimi, ri-hidraulika dhe riparime suvatimi konsiderohen riparime/përmirësime kapitale. Piktura nuk është.
- Për një kamion, zëvendësimi i një motori konsiderohet si një riparim kapital/përmirësim. Goma të reja nuk janë

Ligji sqaron trajtimin shpenzimeve të riparimit dhe përmirësimit nëse ato zgjasin jetën e asetit:

- Për çdo shpenzim mbi 1.000 €, ku shuma e shpenzuar për riparime ose përmirësimet e zgjasin jetën e asetit për një vit, shuma e plotë duhet të kapitalizohet dhe ti shtohet bazës me kosto të amortizuar të asetit. Ajo nuk mund të kërkohet si një shpenzim.
- Kur riparimet dhe përmirësimet nuk e zgjasin jetën e aktivitetit për një vit ose më shumë, shuma e plotë e shpenzimeve mund të jetë shpenzim, edhe në qoftë se ai i kalon 1.000 €.
- Çdo shpenzim nën 1000 € mund të jetë shpenzim në vitin tatimor në të cilën ai ishte paguar ose i shtuar

Kur riparimi dhe mirëmbajtja e shpenzimeve duhet të kapitalizohen, shuma e kapitalizuar duhet të shtohet në vlerën kontabël të asetit. Ky rregull zbatohet për:

- Kategorinë 1 të aseteve, pavarësisht se kur ata ishin të përvetësuar.
- Kategoria 2 dhe 3 e aseteve të përvetësuara që nga 1 janari 2010.

Për kategorinë 2 dhe 3 të aseteve të përvetësuara para kësaj periudhe, shumat e kapitalizuara janë:

- Për riparime në mes 1.000 € dhe 3,000 €, të shtuara në grup si një aset i ri i kualifikuar,
- Për riparime mbi 3.000 €, trajtohen si Kategori 2 ose 3 e aseteve të reja. Zhvlerësimi është i lejuar si zbritje.

#### *Shembull*

Gjendja fillestare e vlerës kontabël të ndërtesës së tatimpaguesit (aset nga kategoria 1) është 100.000 €. Gjatë vitit tatimor 2010, tatimpaguesi shpenzon 4.000 € për riparimin e çatisë që të zgjasë jetën e ndërtesës për pesë vjet. Amortizimi i ndërtesës për vitin tatimor 2010 është i llogaritur si më poshtë:

Gjendja fillestare e vlerës kontabël të ndërtesës	100.000€
Riparimet kapitale dhe përmirësimet	4.000€
Përmbyllja e vlerës kontabël para amortizimit	104.000€
Zhvlerësimi 5%	5,200€
<b>Përmbyllja e vlerës kontabël të ndërtesës</b>	<b>98,800€</b>

**3- Zhvlerësimi i bagëtisë:** është i lejuar vetëm nëse kafshët e tilla janë përdorur gjatë veprimtarisë ekonomike të një njësie ekonomike bujqësore. Zbritja është në dispozicion në përgjithësi për bagëtinë me vlerë të lartë me një origjinë të pastër blegtorale, në 20% amortizim i llogaritur mbi një bazë lineare. Nuk lejohet zbritje për bagëti:

- si rezultat i mbarështimit për përdorim personal apo kafshë qumështore për përdorim personal
- të kultivuara nga tatimpaguesi si kosto e kultivimit të kafshëve do të jenë zbritur tashmë;
- të përvetësuara për ri-shitje, pasi ata do të kenë qenë të përfshira në inventar;
- jo të fituara për ri-shitje, por me një çmim blerje prej më pak se 1.000 €, pasi do të konsiderohen si një shpenzim në vitin e blerjes dhe
- jo të fituara për ri-shitje dhe blihen në mes 1.000 €, dhe 3,000 € më ose pas 1 janarit 2010, pasi këto do të zhvlerësohen, si pjesë e një grupi.

**4 – Zbritjet e Amortizimit** lejohen në fushat e mëposhtme:

- *Shpenzimet për pasuritë e patundshme* mbulon patentat, të drejtat autoriale, licencat për dizajnë dhe modele, kontratat, të drejtat ekskluzive (franshiza) dhe pasuritë e tjera që kanë një jetë të dobishme e të kufizuar. Shpenzimet për këto asete duhet të amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme duke përdorur metodën lineare. Jeta e këtyre aseteve korrespondon me kohëzgjatjen e marrëveshjes ligjore..
- *Shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore* mbulojnë shpenzimet që lidhen me një depozitë natyral të mineraleve dhe burimeve natyrore të tjera. Shfrytëzuesi i depozitit mund të kërkojë zbritje për kostot e kërkimit dhe zhvillimit. Këto shpenzime, së bashku me interesin e lidhur me këtë, duhet të regjistrohen në një llogari kapitale ashtu sikurse ato janë kryer. Në fund të periudhës tatimore, përcakto pjesën e shpenzimeve të kërkimit dhe zhvillimit që i përkasin asaj periudhe duke shumëzuar bilancin në llogarinë kapitale me koeficientin e amortizimit (KA), që është:

$$KA = \frac{\text{Numri i njësive i nxjerrur në vit}}{\text{Totali i vlerësuar i njësive të depozituara}}$$

#### *Shembull*

Biznesi X jep me qira një fushë bakri. Numri i llogaritur i njësive në rezervat natyrore është 15,000,000 njësi. Prodhimi për vit është 1,500,000 njësi. Në fund të periudhës tatimore, bilanci i shpenzimeve kërkimore, kostos së zhvillimit dhe interesi i ndërlidhur në llogarinë kapitale 500.000 €. Për të përcaktuar shumën e zhvlerësimit të lejuar për periudhën tatimore, bilanci në llogari duhet të shumëzohet me koeficientin KA. Në këtë rast, koeficienti është 10%, (1.500.000 / 15.000.000). Zhvlerësimi i lejuar si zbritje është 50.000 €.

Për të mbështetur totalin e njësive të vlerësuara, tatimpaguesi duhet të marrë raportin nga ekspertët e bazuar në metodat e vlerësimit të pranuar në përgjithësi. Ky raport duhet të vihet në dispozicion për ATK-në sipas kërkesës. ATK-ja mund poashtu të përdorë shërbimet e specialistëve të pavarur për të rishikuar raportet e inxhinierisë dhe metodat e llogaritjes së ekstraktit.

**5 – Lejim i veçantë për asete të reja:** Ligji parashikon një lejim të veçantë prej 10% për Kategoria 3 të aseteve të reja të blera në mes të 1 Janarit 2010 dhe 31 dhjetor 2012. Ky lejim i vetëm zbatohet për pajisjet e reja të blera jashtë Kosovës që vihen në përdorim në Kosovë për herë të parë. Lejimi është shtesë **përveç** zhvlerësimit normal, duke dhënë një total prej 110% të amortizimit me kalimin e kohës dhe duhet të deklarohet në periudhën tatimore kur asetit është blerë apo është sjellë në Kosovë. Pajisjet nga Kategoria 3 përfshijnë: makineri bimore, trena, aeroplanë, makinat e rënda të transportit, anijet dhe pajisje të rënda të ndërtimit.

#### *Shembull:*

Biznesi X ka një bilanc fillestar në kategorinë 3 për periudhën tatimore 2010 prej 160,000€. Gjatë gjysmës së parë të vitit, kompania X importon një automjet të rënde transporti nga Gjermania në vlerë prej 40,000€. Zbritja amortizimi për këtë periudhë tatimore do të ketë tri komponente:

- 1) Zhvlerësimi i automjetit të ri si një asset individual:  $40,000 \times 10\% = 4,000\text{€}$ ;
- 2) Amortizimi i grupit të aseteve të kategorisë 3 në dispozicion në fillim të periudhës tatimore 2010:  $160,000 \times 15\% = 24,000\text{€}$ ;
- 3) Kompensim i posaqëm për automjetin e ri:  $40,000 \times 10\% = 4,000\text{€}$ .

**Totali i amortizimit të zbritur= 32.000€.**

#### **Kutia [24]**

*Zbritjet totale (mblidh kutitë [20] – [23])*

#### **Kutia [25]**

*Shuma e tatueshme kutia [19] minus kutia [24]*

### **Pjesa III: Zbritjet shtesë**

#### **Kutia [26]**

*Humbja e bartur:* një humbje tatimore është kur të ardhurat janë më të ulëta se shpenzimet dhe zbritjet. Një humbje mund të bartet për shtatë periudha tatimore dhe përdoret si një zbritje në çdonjërin prej atyre viteve deri sa shuma e përgjithshme e humbjes është zbritur. Humbja mund

të kërkohet vetëm nga ana e biznesit që ka krijuar humbje. Nëse biznesi ndryshon organizimin e biznesit, apo ndryshon pronësia me më shumë se 50%, atëherë bartja nuk është më e zbatueshme. Shembuj të një ndryshimi në organizatë të biznesit përfshijnë konvertimin nga biznesi individual në një ortakëri apo në një entitet të inkorporuar..

#### *Shembulli 1*

Një ortakëri është e drejtuar nga Ortakët A, B dhe C. Secili ka një pjesë të barabartë në ortakëri. Ortakëria ka humbje tatimore prej 10,000 € në vitin 2010. Në 2011, C largohet dhe është zëvendësuar me një ortak të ri, D. Prandaj:

- Humbja tatimore për 2010 mund të bartet në 2011 pasi ka dy të tretat e pronësisë të zakonshme (Ortakët A dhe B).

Në 2012, B largohet dhe është zëvendësuar nga një ortak i ri, E. Prandaj:

- Humbja tatimore për 2010 nuk mund të bartet në 2012, pasi tani është vetëm një e treta e pronësisë të zakonshme (Ortaku A).

Çdo humbje tatimore e bërë në 2011 mund të bartet, pasi është një pronësi e zakonshme e dy të tretave në mes të 2011 dhe 2012 (Ortakët A dhe D). Secili ortak mund të kërkoj pjesën e humbjes bazuar në përqindjen e tij/saj në ortakëri.

#### **Kutia [27]**

*Zbritjet për kontributet bamirëse:* Ligji lejon kompanitë që paguajnë tatim mbi një bazë reale të fitimit për të marrë zbritje për kontributet për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, për mbrojtjen e mjedisit, dhe organizatave sportive, deri në 5% të të ardhurave të tatueshme kutia [25]. Këto organizata duhet të regjistrohen si organizata jo-qeveritare me Qeverinë e Kosovës ose të veprojnë mbi një bazë jo-komerciale në fushat e përmendura mësipërm. Personat fizik dhe bizneset, që paguajnë tatimin mbi një bazë të paragjykuar, nuk mund të pretendojë për kontribute bamirëse..

#### **Kutia [28]**

*Totali i zbritjeve shtesë: Mblidh kutitë [26] + [27]*

#### **Kutia [29]**

*Të ardhurat e tatueshme pas tatimit: Kutia [25] minus kutia [28]*

#### **Kutia [30]**

*Tatimi në të ardhurat e tatueshme sipas tatimit në kllapa:*

E ardhura e tatueshme	Shkallet tatimore
960€ apo më pak	0%
960€ deri 3,000€	4% e shumës mbi 960€
3,000€ deri 5,400€	81.60€ plus 8% e shumës mbi 3,000€
Më shumë se 5,400€	273.60€ plus 10% e shumës mbi 5,400€

#### *Shembuj*

E ardhura e tatueshme	Kalkulimi	Total i tatimit
2,600€	$2,600 - 960 = 1,640 \times .4\%$	65.60€
4,800€	$81.60 + (4,800 - 3,000 = 1,800 \times .8\%)$	225.60€
22,000€	$273.60 + (22,000 - 5,400 = 16,600 \times .10\%)$	1933.60€

Shkruaj shumën totale të tatimit në kutinë [30].

#### ***Pjesa IV: Tatimi i mbajtur në burim gjatë vitit***

##### **Kutia [31]**

*Tatimi mbajtur në burim për paga të punonjësve:* Shkruaj shumën totale të parasë të cilën është duke e mbajtur në burim punëdhënësi i juaj për qëllime tatimore. Bashkëngjit kopjet e certifikatave të mbajtjes në burim për të vërtetuar atë shumë.

##### **Kutia [32]**

*Tatimi i mbajtur në burim nga bankat:* shkruaj totalin e shumës e tatimit të mbajtur në burim nga institucionet financiare. Bashkëngjit kopjet e certifikatave për të vërtetuar atë shumë

##### **Kutia [33]**

*Tatimi i mbajtur në burim nga qiraja:* shkruaj shumën totale të tatimit të mbajtur në burim për qira nga qiramarrësit jo-individual. Bashkëngjit kopjet e certifikatave për të vërtetuar atë shumë.

##### **Kutia [34]**

*Tatimi i mbajtur në burim nga fitimet nga lotaria:* Shkruaj shumën totale të tatimit të mbajtur në burim nga fitimet e lotarisë. Bashkëngjit kopjet e certifikatave për të vërtetuar atë shumë.

##### **Kutia [35]**

*Krediti tatimor në burim të huaj:* Nëse ju keni një ose më shumë njësi të përhershme jashtë Kosovës, dhe ju keni paguar tatimin në fitim në cilindo shtet ku ju keni një seli të përhershme, ju keni të drejtë për një kredi që keni paguar për tatimin mbi të ardhurat e juaja, deri sa shuma nuk është më e lartë se shuma që ju do të keni paguar në Kosovë. Një vërtetim zyrtar nga Autoriteti Tatimor i shtetit të huaj është i nevojshëm. Kjo përfshin tatimin në të ardhura nga tatimi në dividenda, interesa, shitje të pronës dhe çfarëdo aktiviteti tjetër biznesor jashtë Kosovës. Një vërtetim zyrtar nga Autoriteti Tatimor i shtetit të huaj është i nevojshëm.

##### **Kutia [36]**

*Tatimi i mbajtur në burim dhe kreditë:* Mblidh kutitë [31] deri [35]

##### **Kutia [37]**

*Totali i tatimit për pagesë gjatë periudhës:* Kutia [30] minus [36]

##### **Kutia [38]**

*Pagesat tremujore në formë të paradhënies nga të ardhurat e biznesit:* shkruaj shumën e pagesave paradhënie të bëra gjatë secilit tremujor të vitit tatimor.

##### **Kutia [39]**

*Pagesat tremujore në formë të paradhënies nga e ardhura për qira dhe prona e patrupëzuar:* Shkruaj shumën e pagesave të bëra nga e ardhura për qira dhe prona e patrupëzuar gjatë secilit tremujor të vitit tatimor.

##### **Kutia [40]**

*Totali i pagesave në formë të paradhënies:* Mblidh kutitë [38] + [39]

##### **Kutia [41]**

*Totali i tatimit për pagesë: Kutia [37] minus [40]*

### ***Pjesa V: Shuma e papaguar apo rimbursimi***

- Nëse rezultati në kutinë [41] është pozitiv, ju keni tatim borxh. Shkruaj atë shumë në kutinë [42].
- Nëse rezultati është negativ, ju keni të drejtë për rimbursim. Shkruaj atë shumë në kutinë [43].

#### **Kutia [42] Shkruaj shumën e papaguar**

#### **Kutia [43] Rimbursimi**

Ju mund të zgjidhni të kërkonti për rimbursim, ose duke aplikuar atë në një periudhë tjetër tatimore, duke përfshirë periudhat e ardhshme. Ju gjithashtu mund të aplikoni atë në një detyrimin tjetër tatimor, ose ATK-ja mund të vendos të aplikon shumën tek ai borxh.

- Pa marrë parasysh se si ju zgjidhni të merreni me rimbursimin, ju duhet të shënoni shumën në këtë kuti

#### **Kutia [44]**

Shkruaj emrin e bankës.

#### **Kutia [45]**

Shkruaj emrin e personit juridik të regjistruar në llogari

#### **Kutia [46]**

Shkruani numrin e llogarisë në të cilën pagesa duhet të transferohet. Kthehu tek Faqja 1 për të përfunduar kutitë [47] dhe [48].

## Njohja me Faqen 3, Të Ardhurat dhe Shpenzimet sipas Aktivitetit

*Kjo pjesë i përket regjistruarëve të bizneseve individuale të cilët paguajnë tatim në baza reale. Tatimpaguesit të cilët regjistrojnë si persona fizik dhe bizneset e vogla individuale të cilët paguajnë tatimin në bazë të parajgykuar nuk kanë nevojë të plotësojnë këtë deklaratë.*

### **Të ardhurat nga aktivitetet operative**

Për regjistruarët nga biznesi, baza e deklaratës për TAP është llogaritja e fitimit neto. Kjo deklaratë do të ndihmojë që të përcaktoni neto fitimin e bazuar në pasqyrat financiare të biznesit tuaj.

*Disa këshilla ...*

- Sigurohuni që të përfshini këtë pasqyrë me deklaratën për TAP.
- Kur nuk është e aplikueshme, shënoni "0".

### **Kutia [60] Qarkullimi**

*Qarkullimi është shuma e përgjithshme e të ardhurave të një biznesi të ndodhura nga të gjitha burimet gjatë vitit tatimor, përpara zbritjes së çfarëdo kostoje ose shpenzimi. Udhëzimi Administrativ nr 13/2010 ka sqaruar disa pika në lidhje me llogaritjen e të ardhurave:*

#### *Të ardhurat nga ndërtimet afatgjata*

Duke filluar nga 1 janari 2010, Tatimpaguesit e angazhuar në projekte apo kontrata afatgjata të ndërtimeve mund të jenë subjekt i rregullave të veçanta për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme. Ligji përcakton ndërtimet afat-gjata si kontrata dhe projekte që shtrihen përtej një viti të të ardhurave.

Shembuj të kontratave të tilla përfshijnë:

- ndërtimin e ndërtesave, urave, digave, tubacioneve dhe tuneleve
- shkatërrim, pastrim dhe projekte të lëvizjeve të rënda të tokës
- ndërtimin e uzinave të madha, duke përfshirë anijet dhe anijet e transportit
- ngrohje të mëdha, ajër të kondicionuar, instalime elektrike ose projekte të ri-instalimeve
- renovime të mëdha të hoteleve, dyqaneve, etj, dhe
- kontratat të mëdha të menaxhimit të ndërtimit

Këto rregulla nuk zbatohen për kontratat për shitjen dhe furnizimin me stoqe të tregtuara, të tilla si mobile për një ndërtesë të re, madje edhe kur mobilet duhet të jenë montuar në dorëzimin e tyre.

Tatimpaguesit e angazhuar në kontrata dhe projekte afatgjata të ndërtimit janë të përfshirë në tri kategori:

- *ndërtuesit* - ata të cilët kryejnë punë ndërtimore, drejtpërdrejt ose me anë të nënkontraktorëve, dhe të cilët janë paguar në mënyrë progresive nga një investitor përmes një kombinimi të pagesave në formë të paradhënies, apo pagesave progresive dhe pagesave përfundimtare;

- *investitorët* - ata që financojnë punën nga kontrata e ndërtimit dhe të cilët paguajnë ndërtuesit për atë punë, dhe
- *Ndërtuesit / investitorët* - ata që financojnë dhe realizojnë vetë punimet nga kontrata e ndërtimit.

*Metodat e llogaritjes së të ardhurave:*

- 1- Ndërtuesit duhet të përdorin metodën e vlerësimit të përqindjes të kostos së përfundimit**, në të cilën raportohen të ardhurat dhe shpenzimet të bazuara në pjesët e ndërtimit të realizuar. Shuma totale është e bazuar në pjesët që janë shpenzuar në kontratë si një përqindje e totalit të shpenzimeve të vlerësuara.

*Shembull*

Një kontraktues ndërtimi ka një çmim fiks prej 250,000 € për të ndërtuar një urë gjatë 2010 dhe 2011. Shuma e të ardhurave e rënë dakord në kontratë është 250.000 €. Supozimi fillestar i kontraktuesit për koston e kontratës është 150.000 €. Për të përcaktuar fazën e përfundimit të kontratës, kontraktori vlerëson një pjesë të shpenzimeve që kanë rrjedh si pasojë e punës së kryer gjer tani, duke e mbajtur totalin më të fundit të kostos të kontratës. Një përmbledhje e të dhënave financiare gjatë periudhës së ndërtimit është me sa vijon:

	2010	2011
Shuma e të ardhurave e akorduar me kontratë	250,000	250,000
Shpenzimet e kryera deri më sot	90,000	150,000
Kostoja e kontratës për të përfunduar punën	60,000	
Shpenzimet e përgjithshme të kontratës	150,000	150,000
Fitim i vlerësuar	100,000	100,000
Faza e përfundimit (90.000 / 150.000)	60%	100%

Shumat e të ardhurave, shpenzimeve dhe fitimit të pranuar në pasqyrën e të ardhurave për dy vite është, siç vijon:

	Deri tani	Pranuar vitin e kaluar	Pranuar në vitin aktual
<b>2010</b>			
Të ardhurat (250.000 x 60%)	150,000	Jo e aplikueshme	150,000
Shpenzimet (150,000 x 60%)	90,000	Jo e aplikueshme	90,000
Fitimi	60,000	Jo e aplikueshme	60,000
<b>2011</b>			
Të ardhurat	250,000	150,000	100,000
Kostoja	150,000	90,000	60,000
Fitimi	100,000	60,000	40,000

- 2- Investitorët dhe ndërtuesit / investitorët janë të detyruar të përdorin të ardhurat të tatuara me metodën e përlllogaritur(akruale)**, ku të ardhurat janë raportuar në bazë të pagesave të përlllogaritura (me faturat dhe / ose të drejtën për pranim në bazë të një kontrate) dhe shpenzimet janë të lejuara në mënyrë proporcionale në baza të ngjashme si më sipër.

### Shembull

Një investitor ka një kontratë 2-vjeçare me të ardhurat e përgjithshme të pritura prej 200.000 € dhe kosto totale të 150.000 €. Në vitin e parë, investitori merr 100.000 € së të ardhura dhe shpenzon 50.000 € në formë të shpenzimeve. Bazuar në të *ardhurat e tatuara sipas metodës akruale (përlllogaritur), pranimi i të ardhurave për vitin e parë është siç vijon:*

Të ardhurat në vitin e parë	100.000 € (50% e të ardhurave totale të pritura të kontratës)
Kostoja e zbritshme në vitin e parë	75.000 € (50% e totalit të pritur të shpenzimeve)
<b>Fitimi bruto</b>	25.000 €

Në një vit tatimor me pa të ardhura dhe pa kontrata me të drejtën për të pranuar të ardhura, nuk duhet të raportohen të ardhurat. Nuk lejohen shpenzimet në lidhje me kontratat ndërtimore afatgjata në atë vit tatimor.

### Vini re:

- Kur investitorët apo ndërtuesit / investitorët përfundojnë një kontratë, por nuk kanë shitur të gjitha ndërtimet, dhe të ardhurat (dhe shpenzimet) nga shitjet ende nuk janë të pranuar, vlera e pjesëve të pashitura duhet të regjistrohet si inventar dhe të përfshihet në bilancin e gjendjes të investitorit apo investuesit / ndërtuesit 'derisa të realizohet shitja.
- *Metoda e kontratës së kompletuar*, në të cilën të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet janë raportuar në vitin kur është realizuar kontrata apo projekti, nuk është më e lejuar.
- Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së ka liri veprimi për të nxjerrë një vendim shpjegues publik duke lejuar metodat shtesë të regjistrimit të të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të kontratave afatgjata të ndërtimit.
- Nga periudha tatimore 2010 e tutje, të gjitha kontratat e ndërtimit afatgjatë duhet të llogariten në bazë të njëres nga të dy metodat e përshkruara më lart. Tatimpaguesi duhet të rregullojë të ardhurat e tatuashme për të reflektuar ndryshimin e metodës në periudhën tatimore aktuale.
- Shumë kontrata ndërtimore afatgjata dhe projekte përfshijnë pagesat paradhënie, të cilat mund të paguhen edhe nëse ka pak apo nuk ka fare shpenzime të ndodhura. Nëse tatimpaguesi e përdor *metodën e përlllogaritur(akruale) të të ardhurave të tatuara*, pagesa paradhënie formon pjesën e të ardhurave të tatuashme kur ato pranohen. Nëse një tatimpagues përdor metodën e *përqindjes së koston së vlerësuar të përfundimit*, pagesat paradhënie formojnë pjesën e të ardhurave të tatuashme në bazë proporcionale me vazhdimin e ndërtimit.
- Është e rëndësishme që arkëtimet apo përqindja e përfundimit janë pasqyruar saktë(afërsisht) në fund të çdo viti tatimor. Kur kontrata kërkon faturim përpara fundit të vitit tatimor, tatimpaguesi duke përdorur *metodën e përlllogaritur të të ardhurave të tatuara* nuk mund të shtyjë vlerësimin e të ardhurave të kontratës duke u përmbajtur qëllimisht nga faturimi deri pas përfundimit të vitit tatimor.
- Kur një kontratë afatgjatë e ndërtimit përfshin pagesat e mbajtura, ku një klient mban një përqindje të çmimit të kontratës deri me kalimin e një periudhë të caktuar të mirëmbajtjes,

pagesa të tilla nuk janë pjesë e të ardhurave të tatueshme deri sa kontraktori ose merr ose fiton të drejtën për t'i marrë ato nga klienti. Kur pagesat e mbajtura u janë dhënë kontraktuesit para afatit, me kusht që kontraktori paraprakisht të riparon ndonjë defekt para dorëzimit të punës ndërtimore tek klienti, këto pagesa duhet të trajtohen si të ardhura të tatueshme, kur merren paratë. Një përjashtim nga kjo lind, në qoftë se pagesat janë mbajtur në një llogari të veçantë dhe jo në dispozicion për dhënie ose përdorim të përgjithshëm nga ana e kontraktorit deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit. Në këtë rast, paratë nuk konsiderohen si të ardhura të tatueshme deri sa kontraktori ta ketë të drejtën për ti tërhequr ato.

- Kur transaksionet e shkëmbimit të jenë pjesë e një kontratë afatgjatë të ndërtimit, ato njihen si të ardhura ose shpenzime sipas vlerës së tregut. Në qoftë se vlera e tregut nuk mund të përcaktohet ose të vlerësohet si e arsyeshme, investitori apo ndërtuesi / investitori mund të aplikojnë për të ATK, me evidencë të përshtatshme, duke kërkuar njohjen e transaksioneve të tilla si të ardhura dhe shpenzime në fund të kontratës së ndërtimit.

#### *Të ardhurat nga lizingu*

Udhëzimi Administrativ nr 13/2010 sqaron se të ardhurat e tatueshme nga lizingu financiar dhe operativ janë konsistente me të dyja tretmanet e standardeve të kontabilitetit dhe marrëveshjeve të tilla, si dhe me ligjin për lizing të Kosovës. Një lizing *financiar*, në thelb, transferon pronësinë e një pasurie me pagesat e bëra gjatë një periudhe kohore. Qiramarrësi është i lejuar për të kërkuar amortizimin. Për tu cilësuar si një lizing financiar për qëllime tatimore, lizingu duhet të plotësojë të paktën një nga katër kushtet e mëposhtme:

- Afati i qirasë duhet të kalojë 75% të jetës së dobishme të pasurisë së dhënë. *[Për shembull: një aset ka një jetë të dobishme prej pesë vjetësh, dhe në kontratën e qirasë është më shumë se 45 muaj, që përfaqëson 75% të jetës së dobishme të asetit. Qiraja do të jetë një qira financiare.*
- Pronësia e asetit të dhënë me qira është transferuar tek qiramarrësi në fund të afatit të qiramarrjes.
- Qiramarrësi ka një mundësi për blerjen e pasurisë së dhënë me një çmim të rënë dakord në fund të afatit të qirasë, ose
- Vlera aktuale e pagesave të qirasë, të zbritura në një normë të përshtatshme, e tejkalon 90% të vlerës së tregut të asetit.

### ***Shpenzimet nga aktivitetet operative***

#### **Kutia [61] Inventari fillestar**

Ofroni shumën totale për vlerën e mallrave, materialeve, lëndëve të para dhe produkteve të tjera që ju keni pasur në pronësi apo e kishit në dorë në fillim të periudhës tatimore. *[Shih shënimin më poshtë në kutinë [64] për metodat e inventarit.]*

#### **Kutia [62] Blerjet ose kostoja e prodhimit**

Shënoni këtu shumën e parave të biznesit të shpenzuara në periudhën tatimore për blerjet shtesë ose shpenzimet e lidhura me prodhimin.

#### **Kutia [63] Totali**

Mblidh kutitë [61] dhe [62]

#### **Kutia [64] Inventari përmbyllës**

Sigurojë një sasi të përgjithshme për vlerën e mallrave, materialeve, lëndëve të para dhe produkte të tjera që i keni në pronësi apo e kishit në dorë në fund të periudhës tatimore.

Duke filluar nga viti 2010, tatimpaguesit me të ardhura nga shitja e mallrave, të cilët mbajnë listën (inventarin) duhet të përdorin metodën FIFO (*I pari brenda-i pari jashtë*), ose ndonjë tjetër metodë e lejuar sipas Standardeve të Kontabilitetit të Kosovës (Aktualisht, ato përfshijnë *koston mesatare të ponderuar* ose metoda të veçanta të *identifikimit*). Tatimpaguesit nuk mund të ndryshojnë metodën e inventarit të tyre gjatë një periudhe tatimore, dhe duhet të përdorin të njëjtën metodë të inventarit në vazhdimësi për të tri periudhat tatimore shtesë. Tatimpaguesi i cili dëshiron të ndryshojë metodat pas kësaj periudhe duhet të bëjë kërkesë për vendim nga ATK-ja

Vini re se Standardet e Kontabilitetit të Kosovës po lëvizin në drejtim të Raportimit Financiar Ndërkombëtar, të cilat ndalojnë metodën LIFO (*fundit-brenda - i pari jashtë*). Si e tillë, metoda LIFO nuk është më e lejuar për qëllime të tatimit mbi të ardhurat në Kosovë.

#### **Kutia [65] Kostoja e mallrave të shitura**

Zbrit [64] nga [63]

#### **Kutia [66] Fitimi bruto**

Mblidh kutitë [60] – [65]

#### **Kutia [67] Pagat (duke përfshirë edhe kontributet pensionale)**

Shënoni këtu shumën totale që keni paguar për të punësuarit tuaj, duke përfshirë edhe kontributet e bëra në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

#### **Kutia [68] Zhvlerësimi dhe shpenzimi për amortizim (që nuk përfshihen në koston e mallrave)**

Shënoni shumën e llogaritur për zhvlerësim dhe amortizim.

#### **Kutia [69] Shpenzimet e shitjes**

Tregoni ndonjë kosto tjetër të lidhur me shitjen e mallrave ose shërbimeve.

#### **Kutia [70] Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative (që nuk përfshihen në koston e mallrave)**

Tregoni shpenzimet e tjera, të tilla si tarifatat ligjore, kontratat për shërbime dhe shpenzimet e tjera, që lidhen me administrimin e biznesit .

#### **Kutia [71] Kostoja e Hulumtimit dhe zhvillimit**

Shënoni shumën, nëse ka, të koston që lidhet me hulumtimin dhe zhvillimin.

#### **Kutia [72] Shpenzimet e tjera operative**

Tregoni të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me aktivitetin ekonomik të biznesit që nuk janë regjistruar diku tjetër.

#### **Kutia [73] Totali i shpenzimeve operative**

Mblidh kutitë [67] – [72].

#### **Kutia [74] Fitimi (humbja) nga operacionet**

Zbrit kutinë [73] nga kutia [66].

### **Kutia [75] Të ardhura të tjera apo fitimet**

Shënoni shumën e fitimit të biznesit e fituar nga burimet jo direkt të lidhura me shitjen e mallrave dhe shërbimeve. Kjo mund të përfshijë të ardhurat nga qiraja apo shitja e pasurive të patundshme ose asetëve të tjera; pronësisë së pasurisë së patrupëzuar (shih më poshtë), etj

*Të ardhurat nga pasuria e patrupëzuar*

Ligji i 2010 ka sqaruar kategoritë e mëposhtme, si kategori të pronës së patrupëzuar:

- patentat, shpikjet, formulat, proceset, dizajnët, modelet, sekretet tregtare dhe njohuritë për siç (know-how)
- të drejtat e autorit, duke përfshirë të drejtat për kompozimet muzikore, artistike ose letrare
- markat tregtare, emrat tregtar, apo emrat e markave (brand-it)
- të drejtat ekskluzive (franshiza), licencat apo kontratat
- metodat, programet, sistemet, procedurat, fushatat, anketimet, studimet, parashikimet,
- vlerësimet, listat e klientëve, ose të dhëna teknike
- programe kompjuterike, dhe
- të drejtave të tjera të ngjashme.

Në lidhje me programe kompjuterike, licenca ose dhënia me qira e të drejtave, përfshirë furnizimet *di-si* që janë subjekt i të drejtave të autorit, konsiderohen si pasuri e patrupëzuar. Kjo dallon nga shitja e licencave të tilla dhe qirave, dhe dispozita e furnizimeve dhe shërbimeve për zhvillimin ose modifikimin e programeve kompjuterike, të cilat nuk janë.

### **Kutia [76] Shpenzimet tjera apo humbjet**

Shënoni këtu çdo shpenzim tjetër ose humbje që nuk është regjistruar diku tjetër. Këto mund të përfshijnë humbjet për shitjen ose shkatërrimin e pasurive të patundshme ose pasuritë e tjera.

### **Kutia [77] Fitimi (humbja) nga veprimtaritë jo-operative**

Zbrit kutinë [76] nga kutia [75].

### **Kutia [78] Neto fitimi (humbja)**

Mblidh kutitë [74] dhe [77] për të përcaktuar neto fitimin ose humbjen.

**Shëno këtë shumë në kutinë [9] të deklaratës TAP.**

## Pasi të Dorëzoni

### ***Çfarë ndodh me deklaratën pasi të pranohet?***

Kur marrim deklaratën tuaj, ose në një zyrë rajonale të ATK-së apo nga banka ku keni dorëzuar atë, ne bëjmë regjistrimin e informacionit dhe e futim atë në sistemin tonë kompjuterik. Në shumicën e rasteve, deklaratat vjetore do të përpunohen brenda 30 ditëve nga dorëzimi. Kompjuteri do të gjej çfarëdo gabimi matematikor. Deklarata mund poashtu të shqyrtohet nga një person i stafit të ATK-së.

ATK-ja do të lëshojë një njoftim të vlerësimit, nëse shuma e tatimit të paguar nuk është e saktë.

### ***Kur mund të prisni rimbursimin tuaj?***

ATK-ja do të shqyrtojë të gjitha kërkesat për rimbursim brenda 60 ditëve nga marrja e deklaratës. Dorëzimi i dokumentacionit të kërkuar siguron se deklarata juaj mund të përpunohet shpejt dhe me efikasitet.

Nëse jeni për një rimbursim më të vogël se 500 €, atëherë deklarata e juaj mbi tatimin shërben si një kërkesë rimbursimi. Nëse rimbursimi juaj është mbi 500 €, ju duhet të dorëzoni një kërkesë tek ATK-ja duke përdorur formularin KRR të ATK-së, e cila është në dispozicion në faqen e internetit të ATK-së tek pjesa Shkarko Deklaratat Tatimore.

Nëse keni ndonjë borxh të papaguar tatimor, ATK-ja mund të zgjedhë për të aplikuar shumën e rimbursimit tuaj për këtë borxh. Në raste të tilla, ATK-ja do t'ju njoftojë për këtë veprim. Në disa raste, ATK-ja mundet të kompensohet me kredi nga TVSH-ja kundër një borxhi tatimor mbi të ardhurat.

### ***Cilat janë ndëshkimet dhe interesat që i aplikojmë?***

Ligji i Kosovës jep fuqinë ATK-së për të vënë gjoba dhe kamata, kur tatimpaguesit nuk i përmbushin detyrimet e tyre në kohën e duhur. Masa të tilla nxisin promovimin e përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore dhe sigurojnë me kohë mbledhjen efektive të të ardhurave. Ndëshkimet dhe kamatat janë gjithashtu një çështje e drejtësisë për dhjetëra mijëra tatimpagues që paguajnë shumën e duhur të taksave me kohë.

Sipas ligjit dhe me politikën administrative, ATK-ja është e detyruar të administroj dënime me saktësi, qëndrueshmëri, dhe në mënyrë të paanshme. Rrethanat që mund të rezultojnë me dënime dhe kamata përfshijnë:

- Dështimi për të paraqitur deklaratat vjetore me kohë
- Pagesat e vonuara tremujore apo vjetore
- Nën-pagesa në baza tremujore apo vjetore
- Nën-raportim të të ardhurave dhe / ose mbi-raportim i zbritjeve si shpenzime
- Dështimi për të mbajtur shënime dhe / ose ti bërë vënë ato në dispozicion për ATK-në.

Shumat e gjobave dhe të kamatave janë si më poshtë:

- **Dështimi për të paguar tatimet me kohë** do të rezultojë me një dënim prej 1% të bilancit të tatimit të detyruar për secilin muaj apo pjesë të muajit për të cilën pagesa është vonuar, deri në një maksimum prej 12 muajsh
- **Dështimi për të paraqitur një deklaratë me kohë** do të rezultojë në paraqitjen e një ndëshkimi për vonesë. Kjo shumë është 5% e tatimit të papaguar për secilin muaj apo pjesë të muajit që është vonuar, deri në 25% të tatimit të papaguar.
- **Interesi do të ngarkohet për shumat e papaguara** prej 1.5% në muaj apo pjesë të muajit nga data kur tatimi është papaguar, dhe duke përfshirë datën kur tatimi është paguar.
- **Kompanitë që nuk mbajnë shënime adekuate** do të ngarkohen me një ndëshkim sipas një shume proporcionale të bazuar në madhësinë e biznesit.

ATK-ja ka të drejtë të mbledh gjoba dhe kamata duke përdorur veprimet e njëjta të zbatimit që vlejné për mbledhjen e borxhit tatimor të papaguar. ATK-ja mund të përdor një varg të veprimeve të zbatimit, duke përfshirë mbajtjen mbi llogaritë bankare, pagesat e bllokuara të ardhurave nga palët e treta dhe konfiskimin dhe shitjen e pronës dhe pasurisë.

Nën rrethana të kufizuara, ATK-ja mundet të hyjë në një marrëveshje me një tatimpagues për të krijuar një plan me këste për pagesën e borxhit tatimor të papaguar, gjobat dhe kamatat.

Të drejtat e juaja...	...Dhe Detyrimet e juaja
<ul style="list-style-type: none"><li>✓ të jeni i informuar, i ndihmuar dhe i dëgjuar</li><li>✓ për të paguar asnjë tatim më shumë se keni borxh</li><li>✓ për të apeluar një vendim kundër jush</li><li>✓ për intimitet dhe konfidencialitet</li><li>✓ për siguri në lidhje me procedurat e ATK-së, duke përfshirë çdo gjykim ose auditim</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>✓ të jeni të sinqertë</li><li>✓ të paguani tatimin tuaj me kohë</li><li>✓ bashkëpunoni me zyrtarët e ATK-së</li><li>✓ merrni dhe përdorni numrin fiskal</li><li>✓ ofroni informata të sakta dhe me kohë</li><li>✓ ruani shënimet e juaja</li></ul>

*Për më shumë informata, lexoni Statutin e Tatimpaguesit në uebfaqen e ATK-së.*

### Çka nëse auditoheni?

ATK-ja është e angazhuar për trajtimin e drejtë të të gjithë tatimpaguesve sipas ligjit. Së bashku me fuqinë e saj për të kryer auditime, ATK-ja ka mandat që të përdor metodat e përzgjedhjes së rasteve të cilat *maksimizojnë* analizën si objektiv dhe të *minimizojnë* mundësinë për abuzim të autoritetit të tij.

Kur një tatimpagues apo përfaqësuesi i tij/saj dhe të gjithë të punësuarit kyç janë subjekt të një auditimi, ata duhet të:

- pranojnë një intervistë fillestare nga zyrtarët e ATK-së;
- ti sigurojnë inspektorëve tatimore qasje të plotë në të gjitha objektet përfshirë edhe depot së bashku me të gjitha librat dhe të dhënat, fotokopjen e të gjitha dokumenteve të kërkuara nga inspektorët tatimor;

- vënë në dispozicion stafin për t'ju përgjigjur pyetjeve të inspektorëve tatimor.

Fushëveprimi i auditimit mund të ndryshojë nga shqyrtimi i një deklaratë tatimore gjashtë vjeçare (kontroll i plotë) për auditimin e një ose më shumë periudhave tatimore (një kontroll të shkurtër ose të pjesshëm të kontrollit). Normalisht, ATK-ja do t'i japë tre ditë njoftimi me shkrim për tatimpaguesin, duke i këshilluar ata për qëllimin për të kryer një kontroll. Ky njoftim duhet të tregojë datën, vendin, qëllimin dhe kohëzgjatjen e parashikuar të kontrollit, një kërkesë për një takim të parë me tatimpaguesin, kërkesë për informacion specifik që kanë të bëjnë me kontrollin; së bashku me detaje të tjera për fillimin e zhvillimit të procesit. Përrjashtim nga ky rregull mund të përfshijnë rrethanat në të cilat ATK-ja ka të dhëna se një tatimpagues është:

- përpjekur për të fshehur ose shkatërruar provat
- përgatitur të largohet nga vendi
- keq-pasqyrimi i inventarit të mallrave

Udhëzimi Administrativ nr 15/2010 ofron detaje mbi procesin e kontrollit, duke përfshirë të drejtat e tatimpaguesit për t'iu përgjigjur një raporti paraprak të kontrollit dhe për të apeluar një raport përfundimtar të kontrollit.

### ***Kur do të më vizitojë inspektori tatimor?***

Zyrtarët e ATK-së bëjnë vizitë tek tatimpaguesi për shumë arsye, duke përfshirë si vijon:

- Edukimi i tatimpaguesit
- Aplikacionet për numra fiskal
- Aplikacione për licenca për të drejtuar lojërat e fatit
- Pajtueshmëri me arkat fiskale
- Mbledhja e borxhit
- Deklaratat tatimore të pashlyera
- Kontrollet ne terren për përmbushjen
- Hetimi i akuzave të supozuara penale tatimore.

## Ku të Drejtohem për Ndhmë

Ne duam të bëjmë gjithçka të mundshme për të ju ndihmuar në përmbushjen e detyrimeve tatimore. Nëse keni nevojë për më shumë informacione, ne ju inkurajojmë që të shqyrtoni ligjet dhe udhëzimet administrative përkatëse. Këto janë në dispozicion në faqen tonë të internetit në:

[www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)

Nëse nuk jeni në gjendje për të gjetur përgjigje për pyetjet tuaja, stafi i ATK-së është në dispozicion për të ju ndihmuar.

- Na dërgoni me E-mail pyetjet e juaja në [info@atk-ks.org](mailto:info@atk-ks.org)
- Na thirrni apo vizitoni zyrat tona për edukimin e tatimpaguesve:

**TAK është i  
zotuar për të  
shërbyer gjithë  
popullin e  
Kosovës me  
integritet,  
efikasitet dhe  
drejtë.**

<i>NjTM</i>	038/200 346 41	<i>Drejtoria e ATK-së</i>	038/200 250 17
<i>Prishtina 1</i>	038/200 255 21	<i>Ferizaj</i>	0290/321 668
<i>Prishtina 2</i>	038/200 255 17	<i>Gjakove</i>	0390/330 021
<i>Prizren</i>	029/244 963	<i>Gjilan</i>	0280/326 967
<i>Peje</i>	039/432 812	<i>Mitrovice</i>	028/530 059

### ***Sigurimi i informacionit për tatimin***

Informacioni juaj për tatimin është konfidencial. Nëse, ju duhet të vizitoni apo telefononi zyrën tonë me pyetje specifike rreth deklaratës tuaj, ne MUND t'ju kërkojmë për të identifikuar veten dhe të ofroni identifikimin:

Informacioni i juaj për tatimin është konfidencial. Ju mund të autorizoni dikë, të tillë, si një kontabilist apo llogaritar për të përfaqësuar juve për të diskutuar dosjen tuaj. Ai/ajo duhet të ketë autorizimin me shkrim të nënshkruar nga ju, së bashku me identifikimin dhe kopjet e formularëve tatimor. Në të gjitha rastet, ATK-ja zbaton procedurat e rrepta para dhënies së informacionit tuaj ndonjë pale tjetër.

**LINJËS SË BASHKËPUNIMIT PA PAGESË**

**NGA:**  dhe  TELEKOMUNIKACIONET  
TE SERBISË



**0800-501-501**